



KOMUNA E MALISHEVËS



BULETINI

Nr. 115- Janar 2013 ZYRA PËR INFORMIM - <http://kk.rks-gov.net/malisheve/www.malisheva-komuna.org>



Kuvendi i Komunës së Malishevës

Përmbajtja:

Tejkalohet planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë për 18.77%.....	2
Projektet për sivjet, në fokus të mbledhjes së qeverisë lokale	2
Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa	3
Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës.....	4
KK i Malishevës miratoi një deklaratë për situatën në Luginën e Preshevës	4

Tejkalohet planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë për 18.77%

Malishevë, 10 janar

Sipas të dhënave nga drejtoria komunale për Buxhet dhe Financa, realizimi nga planifikimi i të hyrave nga tatimi në pronë, për vitin 2012, është tejkaluar për 18.77 për qind. Kështu ka bërë të ditur, të enjten, për Zyrën për Informim Publik, drejtori i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa, z.Vesel Krasniqi.



“Planifikimi i realizimit të të hyrave nga tatimi në pronë për vitin 2012, ishte 145 mijë euro, ndërsa shuma e grumbulluar nga zyra e tatimit në pronë, është 172.224 euro, ose shprehur në përqindje, është 118.77 përqind të realizuara”, bëri të ditur drejtori Krasniqi.

Krasniqi, po ashtu bëri të ditur, se ‘gjatë vitit 2012, janë bërë 152 fatura të reja, ndërsa janë regjistruar 17 ankesa, prej tyre 14 ankesa kanë qenë për objekte banimi dhe 4 ankesa kanë qenë për objekte komerciale. Prej këtyre ankesave, 11 janë aprovuar nga Bordi Komunal për shqyrtimin e ankesave”.

Projektet për sivjet, në fokus të mbledhjes së qeverisë lokale

Malishevë, 21 janar



Drejtuar nga Kryetari i Komunës, z.Isni Kilaj, është mbajtur mbledhja vijuese e Këshillit të Drejtorëve, kurse në fokus të këtij takimi kanë qenë projektet që parashihen për këtë vit. Kreu i komunës më këtë rast ka kërkuar nga drejtorët e drejtorive që projektet e tyre t'i drejtojnë në ministritë përkatëse, duke veçuar projektet që kanë të bëjnë me infrastrukturën rrugore, me arsimin si dhe projektet në fushën e shëndetësisë.

Në këtë kuadër u bisedua rreth ngritjes së një objekti të ri të Qendrës së Mjekësisë Familjare në Bellanicë pasi objekti aktual është i dëmtuar dhe nuk plotëson kushtet, edhe në rast të ndonjë renovimi eventual. Renovim ndërkaq do të bëhet për dy objekte tjera të QMF-së në Kijevë dhe Tërpezë.

Drejtori i Urbanizmit z.Esat Paçarizi, bëri të ditur se në bashkëpunim me USAID-in në fshatin Astrazup, do të filloj ndërtimi i trotuareve për këtë lokalitet, kurse drejtori i Administratës Haki Krasniqi ka kërkuar që regjistrimi i kërkesave për të gjitha drejtoritë të bëhet në mënyrë elektronike pasi kjo është edhe kërkesë e institucioneve qendrore të shtetit.

Në takim u trajtuan edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me punën sa më efikase të administratës komunale.

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa

Malishevë, 21 janar

Komiteti për Politikë dhe Financa (KPF), i drejtuar nga kryesuesi i Kuvendit të Komunës, z.Ragip Begaj, ka mbajtur mbledhjen e rregullt, të parën për këtë vit, ku janë shqyrtuar dhe miratuar për mbledhjen e Asamblesë Komunale hartimi i planit të punës për KK dhe formimi i një Këshilli.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), pas shqyrtimit, e kanë miratuar për shqyrtim në mbledhjen e ardhshme të Asamblesë Komunale, propozimin për hartimin e planit të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2013.

KPF, po ashtu pas shqyrtimit, e ka miratuar për shqyrtim në Asamblenë Komunale të Malishevës, edhe propozimin për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi.

Komiteti për Komunitete mbajti mbledhjen e radhës

Malishevë, 30 janar

Komiteti për Komunitete, organ i Kuvendit të Komunës në Malishevë, sot mbajti mbledhjen e tij të rregullt, në të cilin, anëtarët e këtij komiteti, kanë marrë vendim dhe kanë caktuar orarin për vizita në terren.

Në këtë mbledhje janë caktuar datat dhe vendet, të cilat, do ti vizitojnë anëtarët e komiteti, në mënyrë që të njihen drejtpërdrejt me problemet e komuniteteve të caktuara në Komunën e Malishevës.

Komiteti për Komunitete, është njëri prej dy komiteteve të detyrueshme, të formuara nga Kuvendi i Komunës dhe përbëhet nga pesë anëtar. Si çdo mbledhje, edhe sot, kjo mbledhje është monitoruar nga zyrtarët e OSBE-së, misioni në Kosovë.

KK i Malishevës miratoi një deklaratë për situatën në Luginën e Preshevës

Malishevë, 31 janar

Kuvendi Komunal i Malishevës, në mbledhjen e saj të rregullt, ka miratuar një deklaratë, përmes së cilës dënohet largimi i dhunshëm i lapidarit me emrat e dëshmorëve të UÇPMB-ës në Preshevë, dhe përmes kësaj deklarate, kërkohet kthimi i lapidarit në vendin e saj, të vendosur nga organet kompetente të Preshevës.



Në mbledhjen e sotme, KK i Malishevës, ka miratuar Planin e punës së KK-ës për vitin



2013. Po ashtu në këtë mbledhje, Kuvendi i Komunës, miratoi edhe kërkesën e Kryetarit të Komunës, për formimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB), sipas udhëzimit të ri administrativ, ku parashihet përbërja dhe mënyra e veprimit të këtij këshilli.

KK i Malishevës, pas kërkesës së opozitës, ka formuar edhe një komision në nivel të Kuvendit të Komunës, i cili do të merret me trajtimin e çështjes së BENAF-it, pasi kësaj kompanie, i është dhënë në shfrytëzim prona për zhvillimin e biznesit të saj, por që kjo e fundit, nuk i është përmbajtur kontratës së nënshkruar me Komunën e Malishevës.

Në vazhdim, teksti i deklaratës së miratuar, lidhur me situatën në Luginën e Preshevës:

Me anë të kësaj deklarate, ne anëtarët e Kuvendit Komunal të Malishevës, shprehim indinjatë të thellë ndaj veprimit të marrë nga Qeveria e Beogradit, për heqjen e dhunshme të lapidarit me emrat e dëshmorëve të UÇPMB-ës.

Për ne si Kuvend i Komunës, është edhe një reagim shtesë, sepse në mesin e atyre dëshmorëve, në atë pllakë përkujtimore, është edhe biri ynë Agim Elshani, i njohur si “Komandant Malisheva”.

Kërkojmë që lapidari të kthehet në vendin që ishte vendosur nga organet kompetente komunale të Preshevës.

Malishevë, 31.01.2013